

BULETIN JAVOR

28-31 GUSHT 2023



Shprehja

"Rezistenca kibernetike është shumë më tepër se një çështje teknologjike. Shkathtësia dhe ekuilibri janë të domosdoshme..."
Stephane Nappo

e javës

Përmbajtja:

- Siguria Kibernetike për bizneset.
- Këshilla sigurie për bizneset:

Siguria Kibernetike për bizneset.

"Një nga gabimet më të mëdha në bizneset e vogla është se punëdhënësit ose punonjësit nuk krijojnë dhe menaxhojnë fjalëkalimet siç duhet."

Scott Schober

Siguria kibernetike është bërë një domosdoshmëri për bizneset e të gjitha madhësive pasi sistemet dhe rrjetet e tyre që përmbajnë të dhëna të ndjeshme dhe të vlefshme, janë vënë nën kthetrat e aktorëve keqdashës.

Pa një strategji të sigurisë kibernetike, biznesi juaj nuk mund të mbrohet nga kërcënimet duke e lënë atë të pambrojtur ndaj aktorëve keqdashës, të cilët do ta identifikojnë biznesin tuaj si një objektiv të lehtë. Së bashku me mënyrën se si teknologjia ka evoluar gjatë viteve, ka pasur gjithashtu një rritje të qëndrueshme të rreziqeve ndaj bizneseve.




Këshilla sigurie për bizneset:

1. Sigurohuni t'i mbani fjalëkalime tuaja private



2. Mbroni të gjitha pajisjet tuaja me një program antivirusi

3. Mos hapni bashkëngjitjet në emaille të dyshimta . Tregohuni vigjilentë ndaj bashkëngjitjeve Word, Excel, PowerPoint ose PDF.



4. Aplikoni siguri shtesë në procesin tuaj të identifikimit, duke konfiguruar vërtetimin me shumë faktorë (MFA).

BULETIN JAVOR

28-31 GUSHT 2023



Shprehja

"Rezistenca kibernetike është shumë më tepër se një çështje teknologjike. Shkathtësia dhe ekuilibri janë të domosdoshme..."
Stephane Nappo

e javës



Një vulnerabilitet në Skype mund t'i ekspozojë IP tuaj një sulmuesi.

Sulmuesit janë në gjendje të gjejnë adresën IP e një objekti, duke zbuluar potencialisht vendndodhjen e tyre fizike, thjesht duke dërguar një link përmes aplikacionit Skype mobile. Sipas studiuesve të cilët ekspozuan vulnerabilitetin, viktima nuk duhet të klikojë linkun ose të ndërveprojë me hakerin përtej hapjes së mesazhit.

Sulmi mund të përbëjë një rrezik serioz për përdoruesit e aplikacionit.

[Link: Lexo më shumë](#)



Microsoft shton suportin e HSTS në Exchange Server 2016 dhe 2019

Microsoft njoftoi se Exchange Server 2016 dhe 2019 tani vijnë me suportin për *HTTP Strict Transport Security* (i njohur gjithashtu si HSTS).

HSTS është një direktivë e serverit në ueb që udhëzon faqet e internetit të lejojnë lidhjet vetëm nëpërmjet HTTPS, duke i mbrojtur ato nga sulmet e *man-in-the-middle* (MitM).

Ai gjithashtu siguron që përdoruesit nuk mund të anashkalojnë paralajmërimet e certifikatave të skaduara, të pavlefshme ose të pabesueshme, të cilat mund të tregojnë se ata lidhen përmes kanaleve të komprometuara.

[Lexo më shumë](#)

Përmbajtja:

- Një vulnerabilitet në Skype mund t'i ekspozojë IP tuaj një sulmuesi.
- Microsoft shton suportin e HSTS në Exchange Server 2016 dhe 2019
- Discord njofton përdoruesit për shkeljen e të dhënave , e cila impaktoi 180 llogari
- Google, Mozilla- patching alert



Discord njofton përdoruesit për shkeljen e të dhënave , e cila impaktoi 180 llogari

Discord.io, një platformë që u mundëson përdoruesve të Discord të gjenerojnë links të personalizuar për kanalet e tyre, pësoi një shkelje të madhe të dhënash . Sulmuesi shfrytëzoi një dobësi brenda kodit të faqes së internetit, duke nxjerrë më pas në ankand të dhënat e vjedhura, duke përfshirë fjalëkalimet e hashuara, informacionin e faturimit dhe ID-të.

Discord.io njoftoi pezullimin e shërbimeve të tij. Kompania tani është e angazhuar për një rishikim gjithëpërfshirës të praktikave të sigurisë për të forcuar mekanizmat e saj mbrojtës kundër shkeljeve të ardhshme.

[Link:Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT



mozilla
Firefox

Mozilla dhe Google lançojnë përditësime të rëndësishme .

Mozilla lançoi versionin Firefox 117 me patche për 13 vulnerabilitete, duke përfshirë shtatë të vlerësuara me severitet të lartë.

Google lançoi gjithashtu përditësimin e tij të dytë javor për Chrome, tani duke u shfaqur si versioni 116.0.5845.140 për macOS dhe Linux dhe si versionet 116.0.5845.140/141 për Windows. AKCESK rekomandon të gjithë përdoruesit e Chrome dhe Firefox të kryejnë përditësimet e nevojshme

[Link:Lexo më shumë](#)